FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 132

Tiranë – E mërkurë, 25 shtator 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11286, datë 23.9.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 4.9.2019	Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit.....	11183
Urdhër i përbashkët i ministrit të Mbrojtjes dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1242, datë 14.8.2019	Për miratimin e listës së shërbimeve që do të ofrohen nga strukturat vartëse të Ministrisë së Mbrojtjes, me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit.....	11192

DEKRET
Nr. 11286, datë 23.9.2019

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fisnik Ixhmet Rexhepi
2. Tringa Enver Shala
3. Fatmir Liman Muja
4. Idriz Sylë Seferaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 625, datë 4.9.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE KULTURORE PUBLIKE DHE TË FUNKSIONIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE TË THEMELUARA NË FORMËN E FONDACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është miratimi i rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionit, me qëllim ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe miradministrimin e pasurive kulturore publike, duke garantuar aksesin e publikut në këto pasuri dhe përmirësimin e shërbimeve në to.

2. Këto rregulla zbatohen për administrimin indirekt të pasurive kulturore publike nga ana e fondacioneve të themeluara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me partnerë strategjikë ose nga institucionet e specializuara në formën e fondacioneve të trashëgimisë kulturore.

3. Administrimi indirekt i pasurive kulturore publike bazohet në parimet e mëposhtme:

a) Parimin e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në autoritetet publike, partnerin strategjik, publikun dhe komunitetin e studiuesve;

b) Parimin e ligjshmërisë së administrimit në zbatim të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të rekomandimeve të UNESCO-s, kur aplikohet, të udhëzimeve të përcaktuara në planet e miratuara për pasurinë kulturore publike përkatëse;

c) Parimin e pavarësisë dhe efektivitetit të administrimit të fondeve të fondacionit;

ç) Parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj publikut dhe institucioneve publike;

d) Parimin e së drejtës së publikut për akses në trashëgiminë kulturore;

dh) Parimin e respektimit dhe të mbrojtjes së vlerave të natyrës e të biodiversitetit.

4. Për pasuritë kulturore, që ndodhen në zona të mbrojtura mjedisore, fondacioni respekton legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura.

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Këto rregulla zbatohen për administrimin indirekt nëpërmjet:

a) fondacioneve të posaçme të krijuara nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me partnerë strategjikë, sipas shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 171 dhe nenit 172, të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";

b) fondacioneve të krijuara nga institucione të specializuara të trashëgimisë kulturore sipas shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 171, të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

Për këto fondacione nuk zbatohen rregullat e përcaktuara në ndarjen A, të kreut IV, të këtij vendimi.

2. Në këtë vendim përdorimi i termit "Fondacion" përfshin "Fondacionin e posaçëm" dhe "Fondacionin", përkatësisht sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij kreu.

3. Termat e tjerë të përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të përcaktuar në ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

III. RREGULLAT E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE KULTURORE PUBLIKE

1. Administrimi indirekt i pasurive kulturore publike është ushtrimi i funksioneve ruajtëse dhe mbrojtëse, restaurimi, përdorimi dhe shfrytëzimi në të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji, si dhe i veprimtarive të vlerësimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe marrëveshjes së lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit.

2. Administrimi indirekt i pasurive kulturore publike përfshin:

a) administrimin e pasurisë kulturore publike nëpërmjet zbatimit të një modeli administrimi më efektiv nga pikëpamja ekonomiko-financiare dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore;

b) ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin, vlerësimin dhe shfrytëzimin në mënyrë joshteruese, qoftë veç e veç, në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira botërore;

c) krijimin e kushteve për garantimin e aksesit të barabartë në pasurinë kulturore publike;

ç) njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore;

d) zhvillimin e aktiviteteve studimore dhe kërkimore;

dh) financimin e veprimtarive në lidhje me pasuritë kulturore publike.

3.. Përveç pasurive të dhëna në administrim, sipas marrëveshjes së lidhur mes ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit, ky i fundit mund të zotërojë, të posedojë në format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi edhe pasuri të tjera, me vlera kulturore ose jo, kur ky vlerëson se këto pasuri dhe të ardhurat që vijnë prej tyre i shërbejnë qëllimit për të cilin është krijuar.

4. Pasuria kulturore publike e paluajtshme në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, që jepet në administrim indirekt, përcaktohet në marrëveshjen e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe partnerit strategjik për themelimin e fondacionit të posaçëm, si dhe në marrëveshjen për administrimin të lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit të posaçëm, sipas të dhënave në regjistrin e pasurive kulturore të paluajtshme të mbajtur nga Instituti Kombëtar i Trashëgiminë Kulturore/Instituti Kombëtar për Regjistrimin e Trashëgimisë Kulturore.

5. Pasuria, që kalon në administrim indirekt të fondacionit nga institucionet e specializuara ose ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, përcaktohet edhe në marrëveshjen e administrimit që lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit.

6. Pasuritë kulturore publike të luajtshme, që ndodhen në pasurinë kulturore publike të paluajtshme, që jepet në administrim indirekt, kalojnë në administrim të fondacionit sipas inventarit të mbajtur nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të marrë në dorëzim nga fondacioni.

7. Për kategorinë e pasurive kulturore publike me rëndësi universale, marrëveshja e administrimit mes ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Për kategorinë e pasurive kulturore publike me rëndësi kombëtare dhe lokale, marrëveshja e administrimit mes ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit miratohet nga Këshilli i Ministrave.

8. Fondacioni ka përparësi ndaj subjekteve të tjera për marrjen në administrim të pasurive kulturore publike të tjera në afërsi të pasurisë në administrim indirekt, të cilat nga pikëpamja e vlerave kulturore janë të lidhura me pasurinë e dhënë në administrim ose në rast të zgjerimit të territorit të kaluar në administrim ku ndodhet pasuria kulturore publike. Marrëveshja e administrimit e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit parashikon kushtet dhe procedurat për shtrirjen e administrimit indirekt nga fondacioni edhe në këto pasuri të tjera.

IV. KRITERET DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT PËR KRIJIMIN E FONDACIONIT

A. Kriteret e vlerësimit të partnerit strategjik

1. Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, për vlerësimin e partnerit strategjik, mbështetet në plotësimin e të gjitha kritereve, si vijon:

a) Të ketë eksperiencë të mëparshme të bashkëpunimit në fushën e trashëgimisë kulturore;

b) Të ketë bashkëpunime të vazhdueshme e të zgjatura në kohë me qeverinë shqiptare dhe/ose ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucionet e saj të varësisë;

c) Të ketë pasur kontribut të njohur financiar, shkëmbim të vlerave intelektuale e profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;

ç) Të ketë hartuar dhe/ose të ketë realizuar projekte në fushën e trashëgimisë kulturore e të muzeve gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të aktivitetit të tij;

d) Të propozojë një model administrimi që të garantojë ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin e qëndrueshëm, promovimin, gëzimin publik të pasurisë kulturore publike;

dh) Të sigurojë kapacitete financiare dhe ekspertizë të nevojshme për të zbatuar projektin e propozuar;

e) Të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit për zbatimin e projektit të propozuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

2. Bazuar në kriteret e sipërpërmendura, Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore vlerëson nëse subjekti konsiderohet partner strategjik në zbatimin e politikave dhe sigurimin e objektivave të përbashkët në zhvillimin e fushës së trashëgimisë kulturore.

B. Procedura e vlerësimit

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore fillon procedurën për lidhjen e marrëveshjes për themelimin e fondacionit me partnerë strategjikë, me kërkesë të këtyre të fundit.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së shprehjes së interesit dhe dokumentacionit përkatës nga ana e subjektit të interesuar, ia përcjell dokumentacionin përkatës Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

3. Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore shqyrton propozimin e subjektit të interesuar në bazë të kritereve të përcaktuara në ndarjen "A", të këtij kreu, duke bërë vlerësim në terma ekonomiko-financiarë dhe efektiviteti të administrimit të pasurisë kulturore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit përkatës. Gjatë shqyrtimit të propozimit, Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë dhe/ose mund të thërrasë e të dëgjojë subjektin e interesuar.

4. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, njofton subjektin e interesuar lidhur me vendimmarrjen.

5. Në rast të pranimit të propozimit, subjekti i interesuar paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për negocimin e kushteve të marrëveshjes së themelimit të fondacionit.

6. Marrëveshja për themelimin e fondacionit duhet të përmbajë, por pa u kufizuar:

a) përcaktimin e pasurisë kulturore dhe territorit që do të administrohet nëpërmjet fondacionit;

b) qëllimin e veprimtarisë së fondacionit;

c) kontributin e bashkëthemeluesve të fondacionit;

ç) të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me themelimin dhe regjistrimin e fondacionit të posaçëm;

d) organet drejtuese, mënyrën e zgjedhjes, largimit, emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese të fondacionit;

dh) kohëzgjatjen që do të ketë fondacioni, nëse do të parashikohet një afat veprimtarie;

e) mënyrën e mbarimit të fondacionit, si dhe çështje të tjera që do të konsiderohen të rëndësishme.

7. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, pas regjistrimit të fondacionit në regjistrin përkatës të organizatave jofitimprurëse, negocion dhe lidh marrëveshjen për administrimin e pasurisë kulturore.

8. Marrëveshja e administrimit të pasurisë kulturore përfshin, por pa u kufizuar:

a) objektivat e administrimit të pasurisë kulturore dhe funksionet e kompetencat e deleguara të fondacionit;

b) kohëzgjatjen e marrëveshjes;

c) të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me ushtrimin e funksioneve ruajtëse, mbrojtëse, të vlerësimit e administrimit të pasurisë kulturore të paluajtshme;

ç) ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale për kryerjen e veprimtarisë së fondacionit, sipas kërkesave të planit të menaxhimit;

d) çështjet e nënkontraktimit për ushtrimin e funksioneve ruajtëse, mbrojtëse, si dhe të vlerësimit;

dh) mënyrën e kontrollit e të raportimit të palëve;

e) të drejtat dhe detyrimet e palëve në aspektin financiar e teknik;

ë) mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me aktivitetet e përmendura më sipër, mënyrën e përfundimit apo, në çdo rast, të zgjidhjes së marrëveshjes;

f) procedurën e marrjes në dorëzim dhe periudhën tranzitore të kalimit të pasurisë kulturore publike në administrim të fondacionit;

g) mënyrën e transferimit të pasurisë kulturore në administrim pas përfundimit të marrëveshjes;

gj) aksesin e publikut dhe parimet e caktimit të çmimit të biletave në pasurinë kulturore publike.

9. Procedurat e parashikuara në pikat 2, 3, 4, 7 dhe 8, të ndarjes "B", të këtij kreu, zbatohen edhe për fondacionet e krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore.

V. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË FONDACIONIT LIDHUR ME ADMINIS-TRIMIN E PASURISË KULTURORE PUBLIKE

A. Përgjegjësitë funksionale të fondacionit lidhur me administrimin e pasurisë kulturore publike

1. Harton dhe zbaton strategjitë, politikat, procedurat dhe rregulloret e brendshme për kryerjen e aktivitetit të fondacionit, për zhvillimin, mirëmbajtjen, koordinimin, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të pasurisë kulturore publike në zbatim të planit të menaxhimit, i cili realizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara për planet e menaxhimit për pasuritë kulturore dhe planet e tjera të menaxhimit sipas legjislacionit në fuqi.

2. Miraton planet vjetore të veprimtarive tregtare, kulturore, artistike, turistike, edukative dhe kërkimore, në përputhje me planin e menaxhimit të pasurisë kulturore publike. Në këtë aspekt, organizon, mbështet e nxit veprimtaritë me karakter kulturor dhe edukativ për publikun e gjerë.

3. Harton dhe zbaton programet dhe/ose planet e zhvillimit e të administrimit të pasurisë kulturore publike, në përputhje me natyrën dhe masën e zhvillimit, të përcaktuara nga plani i menaxhimit të pasurisë kulturore publike dhe strategjitë e politikat e brendshme të fondacionit.

4. Siguron ekspertizën e nevojshme për mbarëvajtjen e administrimit të pasurisë kulturore, nëpërmjet angazhimit të stafit të kualifikuar dhe marrjes së konsulencave nga ekspertë të fushave të ndryshme, vendas ose të huaj, kur e vlerëson se janë të nevojshme.

5. Promovon pasurinë kulturore publike me komunitetin lokal, si dhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

6. Siguron qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e pasurisë kulturore publike dhe burime të tjera për të mundësuar vazhdimësinë e punës së pasurisë kulturore publike dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efektive.

7. Siguron se pasuria kulturore publike i shërben publikut dhe është e hapur gjatë gjithë vitit.

8. Mbështet, nxit, koordinon dhe mbikëqyr kërkimet shkencore në bashkëpunim me institucione shtetërore e private, kombëtare e ndërkombëtare për promovimin, ruajtjen, pasurimin dhe ekspozimin e trashëgimisë kulturore, për menaxhimin e mirë të pasurisë kulturore publike në administrim.

9. Bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore si dhe informon strukturat e pushtetit qendror e vendor për zhvillime të karaktereve të ndryshme që kryhen jashtë territorit të pasurisë kulturore publike, por që mund të kenë ndikim në të.

10. Bashkëpunon me administratën rajonale të zonave të mbrojtura kur pasuria kulturore përfshihet ose është pjesë e sistemit të zonave të mbrojtura të miratuara, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Bashkëpunon me individë, persona fizikë a juridikë, vendas a të huaj, me fondacione dhe organizmat ndërkombëtarë për njohjen, publikimin dhe tërheqjen e financimeve dhe donacioneve për

ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe përmirësimin e vlerave të pasurisë kulturore publike.

12. Krijon kushte sa më të mira për vizitorët, nëpërmjet një infrastrukture bashkëkohore për zhvillimin e turizmit kulturor.

13. Administron të ardhurat që krijohen nga të gjitha veprimtaritë e kryera në pasurinë kulturore publike dhe hapësirën e dhënë në administrim.

B. Përgjegjësitë funksionale të fondacionit lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore publike

1. Fondacioni është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore në përputhje me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", këtë vendim dhe marrëveshjen e administrimit të lidhur ndërmjet fondacionit dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Në kuadër të funksioneve ruajtëse fondacioni:

a) miraton kalendarin vjetor të masave për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë kulturore publike që ka në administrim, në përputhje me planin e menaxhimit dhe planet e konservimit/restaurimit të pasurisë kulturore;

b) krijon një fond të posaçëm për rastet e paparashikuara, në përputhje me planin e biznesit;

c) informon institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për çdo dëmtim, zbulim apo çdo veprim të parashikuar në ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";

ç) koordinon punën me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore për hartimin, miratimin e projekteve të ndërhyrjeve, zbatimin e punimeve, si dhe mbikëqyrjen e kolaudimin e tyre;

d) mbulon shpenzimet për projektimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërhyrjes ruajtëse, sipas buxhetit të miratuar nga Bordi;

dh) garanton marrjen e masave për të siguruar ruajtjen e pasurisë kulturore publike sipas mënyrave të trajtimit, normave teknike dhe kritereve e modeleve të ndërhyrjes në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

e) mban informacionin për pasurinë kulturore publike që ka në administrim, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Fondacioni merr lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për kryerjen e ndërhyrjeve të parashikuara në planet e konservimit/restaurimit, ndryshimin e destinacionit të pasurisë kulturore, si dhe kryen njoftimin e menjëhershëm pranë organeve kompetente. Ndërhyrjet e parashikuara në planet e konservimit/restaurimit të pasurive kulturore, që mund të kenë ndikim në mjedis dhe natyrë, u nënshtrohen kërkesave të legjislacionit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

4. Fondacioni lidh marrëveshje me persona fizikë ose juridikë për ruajtjen dhe sigurinë fizike, në përputhje me kriteret e ruajtjes e të mbrojtjes fizike të objektit, të parashikuara në planin e menaxhimit dhe marrëveshjen përkatëse.

5. Fondacioni kërkon ndihmën e Policisë së Shtetit, Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe shërbimeve të tjera të emergjencës në kryerjen e detyrave të tyre në funksion të mbrojtjes së pasurisë shtetërore.

6. Në marrëveshjen e lidhur ndërmjet fondacionit dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra dhe llojet e veprimtarive ruajtëse e mbrojtëse që do të kryhen nga palët.

7. Studimi, projektimi, zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve në pasurinë kulturore publike në administrim indirekt kryhen nga subjekte të licencuara, të kontraktuara nga fondacioni, pas miratimit nga organet shtetërore përkatëse sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

8. Në çdo rast, fondacioni është i detyruar të njoftojë paraprakisht institucionin e specializuar kompetent për fillimin e punimeve të zbatimit për të lejuar mbikëqyrjen e tyre.

C. Përgjegjësitë funksionale të fondacionit lidhur me format e tjera të mbrojtjes dhe ruajtjes së pasurisë kulturore publike

1. Lëvizja me qëllim ekspozimin e pasurive kulturore të luajtshme në ekspozita dhe panaire, pjesë e pasurisë kulturore publike në administrim indirekt, mund të kryhet nga fondacioni me miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me kushtet dhe kriteret për shfaqjen e pasurive kulturore në ekspozita dhe panaire, të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Fondacioni mund të organizojë ose të lejojë zhvillimin e aktiviteteve artistike e social-kulturore në mjediset e pasurisë kulturore publike që ka në administrim, sipas kalendarit të aktiviteteve të miratuara nga organi i tij vendimmarrës dhe

procedurave të tij të brendshme, duke garantuar përmbushjen e kushteve të ruajtjes, të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore mbi vlerësimin e interesit kulturor, për të cilat është rënë dakord në marrëveshjen e administrimit. Çdo veprimtari e palëve të treta në pasurinë kulturore publike të dhënë në administrim të fondacionit kryhet vetëm me miratimin paraprak të këtij të fundit.

3. Fondacioni në veprimtaritë që organizon duhet të garantojë integritetin fizik të pasurisë kulturore publike dhe promovimin e vlerave të pasurisë kulturore.

4. Vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, përfshirë ato që mund të përdoren nga subjekti që kryen ndërhyrje për mbulimin e skelave e të strukturave mbajtëse, në territorin e pasurisë kulturore, si dhe fotografimi e filmimi i pasurive kulturore për qëllime fitimprurëse administrohen nëpërmjet fondacionit, në përputhje me kushtet e ruajtjes së pasurisë kulturore publike, të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, për të cilat është rënë dakord në marrëveshjen e administrimit.

5. Fondacioni zbaton procedurat e tij të brendshme për përzgjedhjen e subjektit për kryerjen e veprimtarive tregtare brenda pasurisë kulturore publike që ka në administrim. Në ushtrimin e aktiviteteve tregtare fondacioni zbaton kushtet dhe kriteret e pasurisë kulturore, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, për të cilat është rënë dakord në marrëveshjen e administrimit të lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit.

6. Fondacioni, rast pas rasti, mund të përcaktojë rregulla që ofrojnë standarde më të larta për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore.

7. Fondacioni duhet të garantojë sigurinë dhe ruajtjen e pasurisë kulturore publike nga rreziku i zjarrit, duke marrë masat e nevojshme për respektimin e rregullave dhe standardeve në kompletimin me mjetet manuale dhe automatike të sinjalizimit dhe shuarjes së zjarreve për pasuritë kulturore publike.

Ç. Përgjegjësitë e fondacionit lidhur me aksesin dhe shërbimet për publikun në pasuritë kulturore

1. Fondacioni garanton aksesin e publikut në pasuritë kulturore publike në administrim indirekt në përputhje me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", kriteret e parashikuara në marrëveshjen e lidhur me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe rregulloret e miratuara nga vetë fondacioni.

2. Hyrja në pasuritë kulturore publike, institucionet apo vendet e kulturës të administruara nga fondacioni mund të kryhet me ose pa pagesë, në përputhje me marrëveshjen e administrimit. Në zbatim të pikës 5, të nenit 176, të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", fondacioni, në përputhje me marrëveshjen e administrimit për pasurinë kulturore publike që ka në administrim, përcakton:

a) rastet e hyrjes me ose pa pagesë;

b) kategoritë e biletave të hyrjes dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të tyre;

c) mënyrën e emetimit, shpërndarjes dhe shitjes së biletave të hyrjes.

3. Të ardhurat, që vijnë nga shitja e biletave të hyrjes në pasurinë kulturore publike, institucionin apo vendin e kulturës në administrim indirekt, derdhen në llogarinë e fondacionit.

4. Fondacioni, në kuadër të administrimit të pasurisë, mund të ofrojë shërbime për publikun, të tilla si, por pa u kufizuar në:

a) pritjen, përfshirë ato të asistencës e të argëtimit për fëmijët, shërbimet e informacionit, të guidave dhe asistencës didaktike, dhe qendrave të takimit;

b) kafeterinë, ushqimin e gardërobën;

c) botimin dhe shitjen e katalogëve, fletëpalosjeve, botimeve të tjera të ngjashme, incizimeve audiovizive e informatike, çdo material tjetër informativ, si dhe riprodhimin e pasurive kulturore;

ç) menaxhimin e përmbledhjeve diskografike, të diapotekave dhe bibliotekave muzeore;

d) menaxhimin e pikave të shitjes dhe përdorimit tregtar të riprodhimit të pasurive;

dh) organizimin e panaireve dhe manifestimeve kulturore si dhe të nismave promovuese.

5. Administrimi i këtyre shërbimeve përcaktohet në marrëveshjen e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit. Marrëveshja mund të parashikojë edhe ofrimin e shërbimeve të tjera, sipas tipologjisë së pasurisë. Shërbimet për publikun duhet veçanërisht të garantojnë aksesin në pasuritë kulturore publike të personave me aftësi të kufizuar.

D. Përgjegjësitë e fondacionit lidhur promovimin e pasurive kulturore dhe aktiviteteve studimore e kërkimore

1. Fondacioni mund të ndërmarrë veprimtari për promovimin e pasurisë kulturore në administrim, të tilla si:

a) informimin në shkolla dhe/ose universitete;

b) kurse formimi nëpërmjet vënies në dispozicion të materialeve të ndryshme didaktike dhe hapësirave për aktivitete edukimi;

c) veprimtari studimore, kërkimore;

ç) aktivitete të tjera njohëse, si dhe shpërndarjen e rezultatit të këtyre veprimtarive.

2. Kryerja e aktiviteteve të promovimit dhe llojet e mënyra e ofrimit të tyre përcaktohen në marrëveshjen që lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe fondacionit, në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

DH. Përgjegjësitë e fondacionit lidhur me përdorimin, qarkullimin dhe veprimtaritë arkeologjike të pasurive kulturore publike

1. Fondacioni, në kuadër të funksioneve të administrimit sipas nenit 172, të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", jep në përdorim të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë pasuritë kulturore publike që ka në administrim indirekt, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Fondacioni nuk mund t'u japë në përdorim për qëllim rijetëzimi, palëve të treta, pasuritë kulturore publike që ka në administrim indirekt. Pasuria në administrim indirekt mund të përdoret me qëllim rijetëzimi vetëm prej fondacionit, në kuadër të funksioneve të administrimit.

3. Procedurat, kohëzgjatja e kontratës, tarifat për dhënien në përdorim përcaktohen nga organi vendimmarrës i fondacionit, në përputhje me procedurat e brendshme dhe statutin e fondacionit, duke garantuar ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit fizik të pasurisë kulturore, si dhe parimet e përmendura në këtë vendim.

4. Për qarkullimin e pasurive kulturore në administrim indirekt, fondacioni zbaton kushtet dhe masat e nevojshme për qarkullimin civil, fizik dhe ndërkombëtar të pasurive kulturore në përputhje me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Veprimtaritë arkeologjike, kur aplikohen, brenda territorit dhe kufijve të zonës së dhënë në administrim indirekt kryhen nga subjekte të licencuara dhe të pajisura me lejen përkatëse për veprimtarinë arkeologjike, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e trashëgimisë kulturore, pas miratimit nga fondacioni për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike brenda hapësirës dhe kufijve të zonës së dhënë në administrim indirekt.

VI. PËRGJEGJËSITË E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

1. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mbështet fondacionin në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes me qëllim miradministrimin e pasurisë kulturore publike dhe shërben si garant i ruajtjes së vlerave kulturore të pasurisë.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, siguron gëzimin e qetë të pronës për fondacionin dhe e garanton atë ndaj çdo pretendimi të palëve të treta lidhur me pronësinë në të gjithë sipërfaqen në përgjegjësi administrimi, të cilën e kalon në administrim indirekt, që mund të pengojë zbatimin e planeve dhe programeve të fondacionit për administrimin efektiv të pasurisë kulturore publike, në përputhje me planin e biznesit dhe planin e menaxhimit të miratuar sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

3. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ushtron të gjitha funksionet e parashikuara nga ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore shtetërore dhe përmbush të gjitha detyrimet e parashikuara për pronarët e pasurive kulturore të paluajtshme, duke përfshirë edhe detyrimet ndaj fondacionit të posaçëm, sipas marrëveshjes së themelimit të lidhur me partnerin strategjik dhe marrëveshjes së administrimit të lidhur me fondacionin.

4. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore garanton dhe angazhohet me fondacionin për:

a) mostjetërsimin e asnjë pjese të pasurisë kulturore publike në përgjegjësinë e saj të administrimit, sipërfaqes së dhënë në administrim apo pasurive kulturore të luajtshme që ndodhen në të, gjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë së fondacionit;

b) mbarëvajtjen e bashkëpunimin me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, si dhe subjektet private, për të siguruar zbatimin e planit të menaxhimit, planit të biznesit dhe programeve të fondacionit;

c) bashkëpunimin në nivel institucional për marrjen e lejeve, autorizimeve të nevojshme nga autoritetet qendrore e vendore për zbatimin e planit të biznesit;

ç) dhënien e asistencës së Policisë së Shtetit, Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, shërbimeve të tjera të emergjencës, si dhe institucioneve të tjera publike sipas fushës së kompetencës së tyre.

5. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore merr masa të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të ndaluar çdo zhvillim apo veprimtari brenda dhe jashtë territorit të pasurisë kulturore publike që mund të ketë ndikim negativ për pasurinë kulturore publike apo që pengon administrimin efektiv nga fondacioni dhe/ose që ndalohen nga plani i menaxhimit, kur nga masat e marra nga fondacioni sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjes së administrimit nuk është arritur të shmangen ngjarjet e sipërpërmendura.

6. Në ushtrim të funksioneve për mbështetjen dhe garantimin e ruajtjes së vlerave kulturore të pasurisë, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore monitoron dhe vlerëson periodikisht veprimet e fondacionit në zbatim të marrëveshjes së administrimit dhe rregullat e monitorimit të miratuara nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në përfundim të monitorimit, fondacionit i dorëzohet raporti i monitorimit me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

7. Në cilësinë e institucionit qendror kompetent në fushën e trashëgimisë kulturore në përputhje me ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore kryen vetë ose nëpërmjet institucioneve të saj të varësisë, sipas rastit, detyrat e mëposhtme:

a) Miraton në planin e menaxhimit të pasurisë kulturore publike programin për ruajtjen e pasurisë kulturore publike në gjendjen ekzistuese dhe hapat që duhen marrë për të parandaluar dëmtimet;

b) Miraton projektet e ndërhyrjeve ruajtëse e jep lejet përkatëse brenda afateve ligjore dhe kryen verifikimet teknike të nevojshme brenda afateve që nuk pengojnë në mënyrë të paarsyeshme kryerjen e ndërhyrjeve të parashikuara;

c) Inventarizon pasuritë kulturore publike, përfshirë pasuritë kulturore publike të luajtshme, që ka në pronësi dhe që kalojnë në administrim indirekt;

ç) Ndjek procesin e katalogimit dhe vendimmarrjen për destinacionin përfundimtar për kryerjen e kërkimeve shkencore për promovimin, ruajtjen, pasurimin dhe ekspozimin e pasurisë kulturore.

8. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore merr masa dhe ndërhyn për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore publike në rastet kur:

a) jemi në kushtet e forcës madhore. Në këtë rast, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore bashkëpunon me fondacionin për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë kulturore;

b) njoftohet nga fondacioni nëse ndërhyrja përkatëse nuk është në përgjegjësinë e këtij të fundit sipas marrëveshjes së administrimit të lidhur ndërmjet tyre;

c) veprimet ose mosveprimet e fondacionit në kundërshtim me ligjin dhe marrëveshjen e administrimit mund të rrezikojnë shkaktimin e një dëmi të menjëhershëm, të rëndë dhe të pariparueshëm të pasurisë kulturore;

ç) parashikohet nga marrëveshja e administrimit e lidhur me fondacionin.

9. Kriteret, rastet dhe mënyra e marrjes përsipër të përgjegjësive rregullohen në marrëveshjen e administrimit që lidhet ndërmjet fondacionit dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

VII. RREGULLAT PËR FUNKSIONIMIN E FONDACIONIT

1. Fondacioni organizohet, funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, legjislacionit për organizatat jofitimprurëse, legjislacionit për trashëgiminë kulturore e muzetë dhe këtij vendimi.

2. Fondacioni krijohet për të ushtruar veprimtari vetëm në fushën e administrimit të pasurive kulturore për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe përdorimin e shfrytëzimin e pasurive kulturore që merr në administrim. Fondacioni mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të ligjshme në përputhje me qëllimin për të cilin është krijuar.

3. Regjistrimi i fondacionit bëhet sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin mbi procedurat standarde të kalimit të pronës në administrim, të miratuar në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

4. Themeluesit e fondacionit të posaçëm janë ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe partneri strategjik i miratuar nga Këshilli Kombëtar për Menaxhimin e Pasurive Kulturore për të krijuar fondacionin e posaçëm. Themelues i fondacionit të krijuar sipas shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 171, të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", është institucioni i specializuar përkatës që ka në administrim pasurinë kulturore.

5. Themeluesit gëzojnë të drejtën e propozimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve që bëjnë përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse dhe ato ekzekutive të fondacionit.

6. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore garanton pavarësinë efektive administrative, financiare, teknike dhe vendimmarrëse të fondacionit.

7. Mënyra e ushtrimit të të drejtave të përcaktuara në këtë kre rregullohet në marrëveshjen e themelimit të lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore e partnerit strategjik dhe në statutin e fondacionit.

8. Themeluesit mbështesin financiarisht mbarëvajtjen e veprimtarisë së fondacionit, sipas marrëveshjes përkatëse të lidhur mes tyre.

9. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në statutin e fondacionit dhe marrëveshjen e posaçme, themeluesit garantojnë të drejtën e pjesëmarrjes në bord dhe për investitorë e donatorë të tjerë të përshtatshëm që mund të ofrohen për mbështetjen e aktivitetit të fondacionit, në përputhje me kërkesat e ligjit. Në kuptimin e kësaj dispozite, investitorë dhe donatorë të përshtatshëm për të marrë pjesë si anëtarë të Bordit të Drejtorëve do të konsiderohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, të cilët nuk kanë konflikt interesi me veprimtarinë e fondacionit, ndajnë të njëjtin vizion për mbrojtjen, ruajtjen dhe vlerësimin e pasurisë kulturore publike dhe të cilët nga eksperienca, përgjegjshmëria, integriteti dhe besueshmëria e tyre, vlera dhe cilësia e sponsorizimit, vlerësohen se do të kishin një kontribut të shtuar në kryerjen e detyrave të Bordit për përmbushjen e misionit dhe objektivave të fondacionit.

10. Organet e fondacionit janë Bordi i Drejtorëve, drejtori Ekzekutiv dhe organe të tjera që mund të parashikohen nga statuti.

11. Organi më i lartë vendimmarrës i fondacionit është Bordi i Drejtorëve. Numri i anëtarëve në Bordin e Drejtorëve përcaktohet në marrëveshjen e themelimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe partnerit strategjik dhe në statut.

12. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve ushtrojnë detyrën e tyre, në përputhje me interesin më të lartë të fondacionit dhe qëllimin për të cilin ai është krijuar. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë përgjegjës personalisht ndaj fondacionit.

13. Kompetencat e Bordit përcaktohen në statutin e fondacionit. Për përcaktimin e natyrës së kompetencave mbahen në konsideratë parashikimet e ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe parashikimet e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Vendimmarrjet që ndikojnë drejtpërdrejt në programin ose objektin e veprimtarisë së fondacionit do të mbeten kompetencë e Bordit Drejtues.

14. Statuti mund të parashikojë organe të tjera këshillimore sipas tipologjisë të pasurisë kulturore publike që i kalohet në administrim dhe planit të menaxhimit.

VIII. FINANCIMI

1. Fondacioni i posaçëm themelohet me bashkëfinancimin nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe partneri strategjik nëpërmjet kontributeve të përcaktuara në marrëveshjen e themelimit të nënshkruar mes bashkëthemeluesve të fondacionit të posaçëm. Fondet e papërdorura dhe të mbartura të pasurisë kulturore publike si të ardhura jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, nëse ka, si dhe depozitat aktuale, fonde publike dhe asete të tjera financiare të destinuara për pasurinë kulturore publike, i transferohen fondacionit të posaçëm me themelimin e tij, si kontribut i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Financimi i fondacionit përcaktohet në vendimin e themelimit, si dhe aktet e themelimit sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse. Burimi i financimit të fondacionit përcaktohet në statutin e tij.

3. Fondacioni ka buxhetin e tij, i cili miratohet dhe administrohet nga Bordi i Drejtorëve, në përputhje me statutin. Të ardhurat në buxhet krijohen nga:

a) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e ofruara, tarifat e përdorimit, biletat e hyrjes dhe të ardhurat e tjera nga veprimtaria e fondacionit;

b) të ardhurat në formën e dhurimeve dhe granteve të përfituara nga themeluesit apo donatorë të tjerë, vendas e të huaj;

c) fondet e përfituara nga buxheti i shtetit, institucione shtetërore, subjekte private për projekte të caktuara;

ç) kontributet e themeluesve, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e themelimit të fondacionit;

d) burime të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Tarifat për shërbimet e ofruara, të gjitha tarifat e tjera të zbatueshme dhe/ose çmimet e biletave përcaktohen nga fondacioni me vendim të Bordit të Drejtorëve, në përputhje me marrëveshjen e administrimit.

5. Të ardhurat e krijuara mbahen në llogarinë e fondacionit dhe përdoren vetëm për kryerjen e veprimtarisë së tij, për të përmbushur qëllimin, funksionet dhe objektivat e tij, në përputhje me marrëveshjen, statutin dhe këtë vendim.

6. Të ardhurat e gjeneruara nga fondacioni nuk konsiderohen fonde publike.

7. Fondacionit, në asnjë rast, nuk i lejohet të marrë kredi, duke ofruar si kolateral pasurinë kulturore publike që ka në administrim. Fondacionit i ndalohet shlyerja e pagesave me të ardhurat e krijuara nga pasuria kulturore publike që ka në administrim, për detyrime ndaj palëve të treta, jashtë objektit të veprimtarisë së tij ose për detyrime jashtë parashikimeve të marrëveshjes së administrimit.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk lejohet shndërrimi i fondacionit në një tjetër formë organizate jofitimprurëse.

2. Në rastin e bashkimit të fondacionit aplikohen të njëjtat kritere si në rastin e krijimit të tij.

3. Rastet e ndarjes dhe mbarimit të fondacionit përcaktohen në marrëveshjen e themelimit të lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me partnerin strategjik dhe/ose në statut.

4. Për të gjitha çështjet, që nuk trajtohen në këtë vendim, zbatohen parashikimet e ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", marrëveshjes së posaçme midis ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe partnerit strategjik, si dhe marrëveshjes së dhënies në administrim indirekt të pasurisë kulturore.

5. Fondacioni i krijuar ruan të drejtën të aplikojë për mbështetje financiare, në kuadër të programeve të financuara, nëpërmjet buxheteve të qeverisjes qendrore apo vendore, ose burimeve të tjera.

6. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 1242, datë 14.8.2019

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHËRBIMEVE QË DO TË OFROHEN NGA STRUKTURAT VARTËSE TË MINISTRISË SË MBROJTJES, ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të pikës 2, të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekteve të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit",

URDHËROJMË:

1. Miratimin e listës së shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara për studentët, sipas lidhjes nr. 1: "Lista me shërbimet e reduktuara që

ofron Instituti i Gjeografisë dhe i Infrastrukturës Ushtarake për studentët", që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MBROJTJES
Olta Xhaçka

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

Lidhja nr.1

LISTA ME SHËRBIMET DHE ÇMIMET E REDUKTUARA QË OFRON INSTITUTI I GJEOGRAFISË DHE I INFRASTRUKTURËS USHTARAKE PËR STUDENTËT

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia e matjes	Çmimi i përdorur (lekë)	Çmimi i reduktuar për studentët (lekë)
1	Hartë Topografike shk.1:10.000	fletë	800	400
2	Hartë Topografike shk.1:25.000	fletë	650	300
3	Hartë Topografike shk.1:50.000	fletë	600	300
4	Hartë Topografike shk.1:100.000	fletë	500	250
5	Hartë Topografike shk.1:200.000	fletë	400	200
6	Hartë Topografike shk.1:500.000	fletë	300	150
7	Hartë Rrugore Shqipëria shk.1:400.000 (një fletë harte)	fletë	950	500
8	Hartë Rrugore Shqipëria shk.1:200.000 (një fletë harte)	fletë	400	200
9	Hartë Rrugore e plotë Shqipëria shk.1:200.000 (3 fletë harte)	fletë	1200	600
10	Hartë Tirana shk.1:12.5000	fletë	600	300
11	Hartë e Metropolit shk.1:75.00	fletë	600	300
12	Hartë detare, Gjiri i Durrësit	fletë	600	300
13	Hartë detare, Gjiri i Vlorës	fletë	1000	500
14	Hartë detare, Spille-Radhimë	fletë	1100	550
15	Skanim dhe pllotim hartë pavarësisht vitit të prodhimit	fletë	1200	600
16	Skanim dhe printim të fotografive ajrore të vjetra të bëra me aparatin në distancë fokale 70 mm	fletë	670	350
17	Skanim dhe printim të fotografive ajrore të bëra pas viteve '90	fletë	800	400
18	Pika të triangulacionit dhe nivelacionit shtetërore	pika	1500	750

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë